



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-063

Prishtinë, më 7 maj 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 7 MAJ 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi dhe Shfqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentes: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 17 dhe 18 prill 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 prill 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 30 prill 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë mbledhje plenare më 10 maj 2012, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Interpelancë me zëvendëskryeministren Edita Tahiri lidhur me fatin e të zhdukurve në raport me bisedimet me Serbinë, në Bruksel, sipas kërkesës së Grupit të deputetëve nënshkrues,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Teatrot,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit të Pavarur të Medieve, për vitin 2011,
11. Shqyrtimi i Raportit të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2011,

12. Shqyrtimi i Raportit të punës të Radio-Televizionit të Kosovës, për vitin 2011,
13. Shqyrtimi i Propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
14. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës,
15. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për amendamentimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, për afat shtesë.
16. Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për parkun kombëtar “Sharri” dhe për Projektligjin për parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Kryesia, pasi e shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi për të marrë pjesë në Seancën Pranverore të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që do të mbahet në Estoni, prej 25 deri më 28 maj 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartpërmendurit në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryesia, pasi e shqyrtoi Propozim-vendimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 10/60, të datës 8 shkurt 2012, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale